

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit- kundërpaditurit [C.P], shtetas Italian, me [Pasaportë Italiane nr. ...], me banim ne ..., – Itali, pronar i [“L...”] me seli në Prishtinë, të cilin me Autorizim e përfaqëson [F.L] – Avokat nga Prishtina, kundër të paditurit-kundërpaditësit [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, që të dy ortak në NTSH [“K...”] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, në kontestin për shkëputjen e ortakërisë, duke vendosur sipas ankesave të palëve, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.585/16, të datës 05.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.11.2018, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa paditësit- kundërpaditurit [C.P] vetëm për sa i përket detyrimeve dhe të drejtave të palëve të vendosura me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.585/16, të datës 05.03.2018, ashtu që pika **I. (A,B,C,D,E,F)** e dispozitivit të këtij aktgjykimi **NDRYSHOHET** në tërësi dhe nën Pikën **I.** gjykohet si në vijim:

1.1 APROVOHEN pjesërisht si të bazuara kërkesëpadia e paditësit-kundërpaditurit [C.P], shtetas Italian, dhe [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, që të dy ortak në NTSH [“K...”] Ortakëri e përgjithshme dhe gjykohet si në vijim:

1.1.1 LEJOHET tërheqja e [C.P], shtetas Italian, me Pasaportë Italiane nr. ..., nga shoqëria tregtare NTSH [“K...”] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, i cili ka të drejtë që nga shoqëria kolektive ta tërheq interesin e tij, të përcaktuar me këtë aktgjykim ndërsa ortaku tjetër [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, Detyrohet personalisht ndaj paditësit-kundërpaditurit për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky aktgjykim.

1.1.2 VËRTETOHET se [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, është pronar i vetëm i NTSH [“K...”] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, me të gjitha asetet dhe gjithë kapitalin që posedon kjo shoqëri: lëndën e parë, mjetet e punës duke përfshirë edhe impiantin dhe të gjithë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë së bashku me investimet e kryera si dhe paratë e gatshme dhe si pronar i vetëm tani e tutje është i autorizuar dhe përgjegjësi i vetëm për të gjitha kërkesat dhe detyrimet e shoqërisë kolektive të krijuara deri në momentin e marrjes së së këtij aktgjykimi dhe atyre që do të krijohen në të ardhmen.

1.1.3 DETYROHET i padituri-kundërpaditësi [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, personalisht, respektivisht NTSH ["K..."] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, që paditësit/kundërpaditurit - Ortakut të tërhequr [C.P], me [Pasaportë Italiane nr. ...], t'ia paguajnë: në emër të investimeve në shoqëri shumë prej 360,716.43 €, në emër të diferencës në realizim nga shitja e asfaltit gjatë vitit 2005 – shumë prej 88,455.40 €, dhe në emër të 50% të fitimit të realizuar gjatë viteve 2006-2016 – shumë prej 383,497.83 €, në shumë të përgjithshme prej **832,668.83 €**

(tetë/qind/e/tridhjetë/e/dy/mijë/e/gjashtë/qind/e/gjashtëdhjetë/e/tetë/euro/e/tetëdhjetë/e/tre/cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET tërësisht si e pabazuar ankesa të paditurit-kundërpaditësit [B.SH], dhe pjesërisht si e pabazuar ankesa paditësit-kundërpaditurit [C.P], ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.585/16, i datës 05.03.2018, në pikat **II, III, IV, V, dhe VI** të dispozitivit, **VËRTETOHEN.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit- kundërpaditurit [C.P], shtetas Italian, me [Pasaportë Italiane nr. ...], me banim ne ... – Itali, pronar i ["I..."] me seli në Prishtinë, ashtu që në pikën I.(A) është zgjidhur marrëveshja e ortakërisë e lidhur në mes të paditësit dhe kundërpaditësit dhe lejohet tërheqja e paditësit ["I..."], me perfaqësus ligjor [C.P], nga NTSH ["K..."], Ortakëri e Përgjithshme. Në pikën I.(B) është vendosur se pronari i vetëm i NTSH ["K..."], Ortakëri e Përgjithshme, mbetet ortaku tjetër kundërpaditësi [B.SH], nga fshati ... Komuna e Ferizajit, me të gjitha asetet që posedon ky biznes, lëndën e parë, mjetet e punës duke e përfshirë edhe impantin, mbi të gjitha investimet e bëra deri me tani duke e përfshirë edhe pronën e palujtshme, si dhe palë e vetme e autorizuar dhe përgjigjese, për të gjitha kreditë dhe debitë e biznesit. Në pikën I.(C) është detyruar kundërpaditësi [B.SH] që t'ia paguajnë paditësit ["I..."], shumë prej 80,000€, në emër të ½ e vlerës së impantit, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, ndërsa në pikën I.(D) paditësi ["I..."], i njihet e drejta në 50% të fitimit të realizuar gjatë viteve 2006-2016, në lartësi prej 383,497.83€ dhe e drejta në marrjen e diferencës në realizimin nga shitja e produktit të asfaltit, që ishte në shumë prej 88,455.40€, në shumë totale

prej 471,952.40€. Në pikën I.(E) konstatohet se paditësi ["I..."], ka mbetur mbrapa me investime në relacion me kundërpaditësin [B.SH], gjatë periudhës sa ishte pjesë aktive e Ortakerisë (deri më 29.08.2005), në një diferencë prej 382,570.75€. Ndërsa në pikën I.(F) është vendosur që të bëhet kompensimi i kërkesave si në pikën I/D dhe në pikën I/E të këtij aktgjykimi, ashtu që, shumës legjitime që do t'i takonte ortakut ["I..."], prej 471,952.40€, i zbritet diferenca në investime prej 382,570.75€ që t'i takonte ortakut [B.SH]. Andaj, detyrohet kundërpaditësi [B.SH], që t'ia kompensojë paditësit ["I..."], shumën prej 89,000.00€, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e kundërpaditësit ["I..."] në pjesën ku ka kërkuar kompensimin e vlerës së impantit, mbi shumën e miratuar prej 80,000.00€, e deri në shumën e kërkuar prej 730,000.00€. Ndërsa në pikën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e kundërpaditësit [B.SH], në pjesën ku ka kërkuar shumën prej 37,300.00€ në emër të kompesimit të dëmit për shkak të krijimit të defektit të qëllimshëm në impant, nga pala paditëse ["I..."]. Në pikën IV. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e kundërpaditësit [B.SH], në pjesën ku ka kërkuar pagesën e shumës prej 117,170.03€, në emër të borxhit të mbetur nga pala paditëse. Në pikën V. është detyruar kundërpaditësi [B.SH] që posa të bëhet ky aktgjykim i formës së prerë, të paraqes kërkesë në ARBK për ndryshimet statusore të biznesit NTSH ["K..."], konform dispozitave ligjore në fuqi, duke pasur për bazë zgjidhjen e marrëveshjes së ortakërisë dhe mbetjen e tij si pronar i vetëm i biznesit. Në pikën VI. është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi-kundërpadituri [C.P], shtetas Italian, me [Pasaportë Italiane nr. ...], me banim ne ..., –Itali, pronar i ["I..."] me seli në Prishtinë , me të cilën ka atakuar aktgjykimin, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ka propozuar që Gjykata e Apelit ta prish Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike me nr.EK585/16 i datës 05.03.2018 dhe çështja kthehet në rigjykim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe i padituri-kundërpaditësi [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, me të cilën ka atakuar aktgjykimin, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ka propozuar që Gjykata e Apelit të miratohet si e bazuar ankesa e te paditurit-kundërpaditësit [B.SH], nga fshati ... Komuna e Ferizajit, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike EK.nr.585/16 të datës 05.03.2018, ose të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe çështja juridike t'i kthehet gjykatës se shkallës së pare në rigjykim.

Përgjigje në ankese ka parashtruar i padituri-kundërpaditësi duke kërkuar nga Gjykata e Apelit që ankesa e të paditurit- kundërpaditësit të refuzohet si jo e bazuar, kurse ankesa e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, ndërsa sa i përket kundërpadisë së paditësit konform dispozitëse së nenit 256, 257 të LPK-së të hudhet poshtë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa paditësit - kundërpaditurit është pjesërisht e bazuar.
Ankesa e të paditurit - kundërpaditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-kundërpadituri [C.P], shtetas Italian, me [Pasaportë Italiane nr. ...], me banim ne ..., – Itali, pronar i [“I...“], me seli në Prishtinë, me datë 16.09.2005, ka parashtruar padi kundër të paditurit [B.SH]. Sipas padisë të dy palët ne konteste ishin ortak në themelimin e një shoqërie të përbashkët tregtare me emrin NTSH [“K...“] të tipit Ortakëri e Përgjithsme, me seli në Lipjan. Për nevojat e këtij biznesi palët kanë blerë edhe makinerinë për prodhimin e asfaltit. Në padi, ndër të tjera është theksuar së paditësi dhe i padituri e kanë regjistruar si biznes të përbashkët, NTSH [“K...“]. Në ndërkohë marrëdhëniet janë përkeqësuar në mes palëve deri në atë shkallë sa që veprimtaria e përbashkët është pamundësuar dhe se i padituri e ka larguar paditësin me dhunë nga vendpunishtja. Pas largimit të tij nga vend punishtja, me biznesin ka vazhduar të operoj vetëm i padituri. Me parashtrësën e datës 01.02.2016, ka precizuar kërkesëpadinë dhe ka kërkuar nga gjykata që t`ia lejojë tërheqjen si ortak nga NTSH [“K...“], dhe të detyrohet i padituri [B.SH] që t`ia kompensojë vlerën e investimit në impiant, në shumën që do të përcaktohet sipas ekspertizës dhe kompensimin e 50% të firitimit të realizuar nga shoqëria gjatë periudhës 2005-2016.

I padituri [B.SH] me datë 30.03.2006, ka paraqitur kundërpadi të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 23.05.2017, duke kërkuar nga gjykata që të zgjidhet kontrata për bashkëpunim në mes të paditësit dhe të paditurit, të përjashtohet paditësi si ortak nga NTSH [“K...“] dhe të vertëtohet se ai është pronar i vetëm i aseteve të shoqërisë , të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet paditësi që atij si kundërpaditës në emër të borxhit t`ia kompensojë shumën prej 117,170.03 €.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka gjetur se, paditësi dhe i padituri me datë 08.01.2005, kanë lidhur Kontratën mbi bashkëpronësinë dhe bashkëpunimin në bazë të së cilës kanë themeluar shoqërinë NTSH [“K...“], me pronësi të barabartë 50% me 50%. Në vitin 2005 kanë filluar aktivitetin ekonomik – prodhimi dhe shitja e asfaltit. Pas filimit të aktivitetit gjatë vitit 2005 kanë filluar mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve si pasojë e të cilave paditësi me datë 29.08.2005 është dëbuar nga vendpunishtja nga i padituri – ortaku [B.SH], nga e cila datë paditësi [C.P] nuk ka pasur qasje në shoqërinë NTSH [“K...“]. Pas largimit të ortakut [C.P], ortaku tjetër [B.SH] ka vazhduar me menaxhimin e shoqërisë si i vetëm. Gjatë kësaj kohe ka gjeneruar fitime nga

aktiviteti i shoqërisë të cilat nuk i ka ndarë me ortakun tjetër. Nga ekspertiza e ekspertit financiar z.[R.B], gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se ortaku [B.SH] i ka investuar në shoqërinë NTSH ["K..."] shumën financiare prej 743,287.18 € ndërsa ortaku tjetër [C.P] shumën prej 360,716.43 € respektivisht diferenca në investime është për 382,570.75 €, ne favor të Ortakut [B.SH]. Poashtu nga ekspertiza financiare ka gjetur se nga shitja e asfaltit Ortaku [B.SH] ka realizuar shumën prej 218,985.00 €, ndërsa ortaku [C.P] shumën prej 130,529.00 €, respektivisht [B.SH] ka realizuar për 88,455.40 € me shumë se ortaku tjetër. Ndërsa lidhur me fitimin e realizuar për periudhën 2006-2016, nga ekspertiza financiare ka konstatuar se gjatë kësaj periudhe shoqëria NTSH ["K..."] ka realizuar fitime në shumën prej 766,955.66 €, e cila ne proporcion me pronësinë e ortakëve (50%:50%), secilit nga ortakët do t'i takonte nga 383,497.83 €, por të cilin fitim e ka përvetësuar në tërësi ortaku [B.SH] ndërsa nuk ia ka ndarë fitimin e shoqërisë ortakut tjetër [C.P] të cilit i takon shuma prej 383,497.83 €.

Prandaj bazuar në dispozitat e Nenit 50 dhe 56 të LSHT-së, ia ka njohur paditësit te drejtën në marrjen e diferencës në realizim nga shitja e asfaltit, në shumë prej 88,455.40 € dhe të drejtën në 50% të fitimit të realizuar në shumë prej 383,497.83 €, respektivisht të drejtën për kompensim të shumës prej 471,952.40 €, të cilën ka për detyrim që t'i paguaj Ortaku [B.SH]. Mirëpo gjykata e shkallës pasi kishte gjetur se ortaku [B.SH] ka investuar në shoqërinë NTSH ["K..."] shumën financiare prej 743,287.18 € ndërsa ortaku tjetër [C.P] shumën prej 360,716.43 €, diferenca në investime për 382,570.75 €, ne favor të Ortakut [B.SH], e ka kompensuar me detyrimin e ortakut [B.SH] ndaj ortakut [C.P] në shumë prej 471,952.40 €, dhe ka vlerësuar se paditësit [C.P] i takon vetëm kompensimi i diferencës në shumë prej 89,381.65 €, andaj ka vendosur si në pikën I. (F) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë përsërisht si të rregullt dhe të ligjshëm, përveq pikës I. (A,B,C,D,E,F) të dispozitivit të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale në raport me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Mirëpo, për kundër këtyre fakteve, gjykata e shkallës së parë në dispozitiv gabimisht e ka përcaktuar lartësinë e kompensimit të cilin ortaku [B.SH] i detyrohet ortakut [C.P]. Prandaj Gjykata e Apelit në këtë pjesë e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në par. I të dispozitivit dhe ka gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit fillimisht ka gjetur se me aktgjykimin e shkallës së parë gabimisht është shënuar si paditës ["I..."] sepse nga të gjitha parashtresat e paditësit rezulton se paditës është [C.P], shtetas Italian, me [Pasaportë Italiane nr. ...], me banim ne ... – Itali, ndërsa shënimet si pronar i ["I..."], në parashtresa janë vendosur për identifikimin e të njejtit në Kosovë, pasi është shtetas i huaj. Nga shënimet zyrtare nga ARBK respektivisht nga Certifikata e Regjistrimit të Biznesit, rezulton se NTSH ["K..."] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, me [NRB ...], ka pronar [B.SH] dhe [C.P], andaj Gjykata e Apelit ia ka njohur të drejtat nga shoqëria ortakut [C.P], ashti siç rezulton nga dokumentet që gjenden në shkresat e lëndës.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila në mënyrë të plotë përputhet me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe me ekspertizën financiare dhe plotësimet e saj, të ekspertit financiar z. [R.B], të cilave i referohet dhe ia ka falur besimin e plotë edhe gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit ka konstatuar të njejtën gjendje faktike ashtu si edhe gjykata e shkallës së parë, por ka gjetur se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka bërë kompensimin e kërkesave kur diferencën në investime për 382,570.75 €, në favor të Ortakut [B.SH], e ka kompensuar me detyrimin e ortakut [B.SH] ndaj ortakut [C.P] në shumë prej 471,952.40 €, dhe ka vlerësuar se paditësit [C.P] i takon vetëm kompensimi i diferencës në shumë prej 89,381.65 €. Ky kompensim do të ishte i drejtë nëse gjykata e shkallës së parë do të kishte vendosur që paditësi [C.P] edhe më tej të mbetej pronar me 50% i shoqërisë NTSH ["K..."] dhe në atë rast do të ishte e kuptueshme barazimi i investimeve me ortakun tjetër [B.SH], por jo edhe në rastin e përjashtimit të ortakut tjetër ortakut tjetër.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në par. I. pikat (A) dhe (B) të dispozitivit e ka përjashtuar në tërësi paditësin [C.P] nga pronësia e NTSH ["K..."] dhe ka vendosur që pronar i vetëm i saj të mbetet ortakut [B.SH]. Andaj është jashtë çdo logjike juridike që nga ortakut që përjashtohet nga shoqëria të kërkohet që të bëjë investime shtese ashtu që të barazohet në investime me ortakun tjetër përderisa nuk është më pronar i asaj shoqërie ndërsa pronar i vetëm i asaj shoqërie mbetet ortakut tjetër [B.SH], i cili bëhet pronar i vetëm i të gjithë kapitalit të shoqërisë përfshirë edhe investimet u urdhëruara nga gjykata për pronarin e përjashtuar. Prandaj Gjykata e Apelit në këtë pjesë e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në par. I të dispozitivit dhe në përputhje me detyrimet e ndërsjella të ortakëve, që rezultojnë nga gjendja faktike e vërtetuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e të konstatuar edhe me ekspertizë financiare, ka gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit duke iu referuar dispozitave të Nenit 50, 56 të LSHT të cilët përcaktojnë të drejtat e ortakut në shoqërinë kolëktive (Ortakëri) ka gjetur se paditësit si ortak i NTSH ["K..."] i takojnë të gjitha të drejtat gjatë kohës sa ka qenë ortak në shoqëri përfshirë: të drejtën e ndarjes së fitimit dhe shpërndarjes, si dhe të drejtat e tjera të ortakut të përgjithshëm; të drejtën në një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, humbjeve, alokimeve dhe shpërndarjeve

të shoqërisë kolektive. Poashtu paditësit i takojnë të gjitha të drejtat e tërheqjes nga shoqëria kolektive, përfshirë të drejtën në fitime dhe të drejtën në tërheqjen e interesit të tij në shoqërinë kolektive, te përcaktuara me Nenin 63 të LSHT-së, e cila dispozitë njekohësisht kohë përcakton se: *“ky detyrim është një detyrim që ka shoqëria kolektive ndaj ortakut të përgjithshëm i cili tërhiqet; dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi, njëlloj sikurse edhe me detyrimet e tjera të shoqërisë kolektive.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara Gjykata e Apelit ka gjetur se paditësit [C.P], me rastin e tërheqjes nga shoqëria NTSH [“K...“], i takon e drejta në tërheqjen e interesit të tij në shoqërinë kolektive, e cila përfshin tërë investimet vetanake në kapitalin e shoqërisë në shumën e vërtetuar prej 360,716.43 €, dhe të drejtën në një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, që përfshin diferencën në realizim nga shitja e asfaltit gjatë vitit 2005 – shumën prej 88,455.40 €, dhe 50% të fitimit të realizuar gjatë viteve 2006-2016 – shumën prej 383,497.83 € (50% nga 766,955.66 €) , në shumë të përgjithshme prej 832,668.83 €, të cilën shumë detyrohet që t’ia paguaj i padituri-kundërpaditësi [B.SH], nga Fsh. ..., Komuna e Ferizajit, personalisht, respektivisht NTSH [“K...“] Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, pasi ky detyrim sipas Nenit 63 të LSHT-së, përbën detyrim që ka shoqëria kolektive ndaj ortakut të përgjithshëm i cili tërhiqet dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi.

Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit në këtë pjesë e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar të dispozitivit duke shuqizuar në tërësi par. I (pikat A,B,C,D,E dhe F) dhe në përputhje me detyrimet e ndërsjella të ortakëve, që rezultojnë nga gjendja faktike e vërtetuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimin.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pabazuara në ligj dhe në kundërshtim të plotë me parimet e drejtësisë pretendimet ankimore të paditësit-kundërpaditurit lidhur me vlerën e impiantit respektivisht kërkesën për njohjen e vlerës së impiantit më çmim prej 730,000.00 €, si investim në shoqëri, sepse nga Dokumentet Unike Doganore (DUD) rezulton se impainti është zhdoganuar sipas çmimit të deklaruar prej 160,000.00 €, andaj nuk mund t’i njihet çmimi prej 730,000.00 €, sepse askush nuk mund të përfitojë nga veprimet e veta që janë në kundërshtim me ligjin.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të paditurit-kundërpaditësit, lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe i referohen çështjeve të menaxhimit të shoqërisë të cilat janë ngritur dhe qartësuar disa herë në procedurën në shkallë të parë, e të cilat nuk janë me ndikim në çështjen e përcaktimit të pronësisë së pronarëve në shoqërinë tregtare, sepse pjesëmarrja në pronësi përcaktohet në bazë të investimeve, dokumenteve statutore dhe dispozitave ligjore e jo nga procedurat e brendshme administrative të shoqërisë, respektimi apo mos-respektimi i të cilave mund të krijojnë përgjegjësi të tjera, por janë pa efekt në

vendosjen lidhur me objektin e shqyrtimit në këtë kontest, respektivisht në përcaktimin e të drejtave të pronarëve në shoqëri tregtare.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditurit-kundërpaditësit, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) dhe e), të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 103/2018, dt. 22.11.2018

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.

